



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*  
*Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health*

**RAPORTI I PLANIT TË INTEGRITETIT INSTITUCIONAL  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
(JANAR-DHJETOR 2024)**

Prishtinë,  
Janar, 2025

## Përbajtja

I. Përbledhje ekzekutive	1
II. Analiza e realizimit të planit të integritetit	2
III. Realizimi i aktiviteteve	3
1. Fusha e rrezikut: Drejtimi dhe menaxhimi	3
Përshkrimi i rrezikut	3
Masat e propozuara	3
Aktivitetet e realizuara	3
Indikatorët kyç të performancës	3
2. Fusha e rrezikut: Planifikimi dhe menaxhimi finansiar	4
Përshkrimi i rrezikut	4
Masat e propozuara	4
Aktivitetet e realizuara	4
Indikatorët kyç të performancës	4
3. Fusha e rrezikut: Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve	5
Përshkrimi i rrezikut	5
Masat e propozuara	5
Aktivitetet e realizuara	5
Indikatorë kyç të performancës	5
4. Fusha e rrezikut: Komunikimi dhe informimi	5
Përshkrimi i rrezikut	5
Masat e propozuara	6
Aktivitetet e realizuara	6
Indikatorët kyç të performancës:	6
5. Fusha e rrezikut: Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve	6
Përshkrimi i rrezikut	6
Masat e propozuara	6
Aktivitete të realizuara	7
Indikatorët kyç të performancës	7
6. Fusha e rrezikut: Prokurimi publik dhe menaxhimi i projekteve/kontratave	7
Përshkrimi i rrezikut	7
Masat e propozuara	7
Aktivitete të realizuara	7

Indikatorët kyç të performancës	7
7. Fusha e rrezikut: Furnizimi me barna	8
Përshkrimi i rrezikut	8
Masat e propozuara	8
Aktivitete të realizuara	8
Indikatorët kyç të performancës	8
8. Fusha e rrezikut: Inspektimi	9
Përshkrimi i rrezikut	9
Masat e propozuara	9
Aktivitete të realizuara	9
Indikatorët kyç të performancës	9
<b>IV. Sfidat</b>	<b>9</b>

## I. Përbledhje ekzekutive

Në Kosovë autoriteti më i lartë për shëndetësi, Ministria e Shëndetësisë (MSh) në pajtim me legjislacionin në fuqi për parandalimin e korruptionit, ka përgjegjësinë kryesore për të krijuar politika dhe për të bërë monitorimin e zbatimit të këtyre politikave, që kanë ndikim në parandalimin e korruptionit potencial dhe sjelljeve tjera jo - profesionale në sektorin e shëndetësisë.

Në këtë drejtim, MSh ka hartuar dhe miratuar Planin e integritetit për periudhën 2024 -2026, i cili plan ofron masa të mbështetura te rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Përmes këtyre politikave e veçanërisht përmes zbatimit të Planit të Integritetit Institucional, Ministria e Shëndetësisë ka shtuar dhe fuqizuar kontrolllet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet duke synuar, që të arrijë të zvogëlojë rrezikun nga korruptioni respektivisht rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës në të gjithë sistemin shëndetësor përfshirë edhe menaxhimin dhe shpenzimet në sektorin e shëndetësisë, veçanërisht në procesin e prokurimit dhe transparencës së këtyre aktiviteteve.

Ministria e Shëndetësisë duke u përkushtuar në zbatimin e legjislacionit dhe në aktivitetet që adreson Plani i Integriteti Institucional ka emëruar edhe mekanizmat, që kanë për detyrë mbikëqyrjen e këtij procesi, raportimin e tyre te akterët kompetent, respektivisht eliminimin e reziqeve të mundshme në bazë të të gjeturave përgjatë procesit të mbikëqyrjes.

Në vitin 2024, janë realizuar një sërë aktivitetesh dhe masash për përmirësimin e menaxhimit dhe operacioneve në sektorin e shëndetësisë. Projektligi për shëndetësi është në fazën e shqyrtimit pas konsultimeve publike, ndërsa Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë për periudhën 2025-2030 është miratuar nga Qeveria. Aktivitetet për monitorimin e dokumenteve strategjike dhe prokurimit janë realizuar me sukses, duke u siguruar që prokurimet janë bërë në përputhje me rregullat dhe afatet ligjore. Një vëmendje e veçantë është kushtuar hartimit të kërkesave tenderuese dhe bashkëpunimit me ekspertë të USAID-KMI për të shmangur gabimet në specifikimet dhe çmimet. Po ashtu, janë kryer veprime për menaxhimin e kontratave, duke përfshirë vënien në dispozicion të urdhërblerjeve dhe monitorimin e pagesave dhe penaliteteve për vonesa.

Në fushën e burimeve njerëzore, janë bërë përpjekje për rekrutimin dhe trajnimin e stafit, duke u siguruar që kërkesat përkatëse janë përbushur. Është krijuar një plan strategjik për komunikim dhe janë realizuar takime të vazhdueshme me njësítë e vaksinimit. Po ashtu, është ndjekur një proces i vazhdueshëm i monitorimit dhe vlerësimit të aktiviteteve. Zhvillimi dhe përditësimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH) ka vijuar, duke përfshirë trajnimin dhe angazhimin e ekspertëve për integrimin e të dhënavëve dhe menaxhimin e moduleve të ndryshme.

Aktivitete të tjera të rëndësishme kanë përfshirë inspektimet sanitare dhe shëndetësore, ku janë realizuar më shumë se 2400 inspektime nga inspektorati shëndetësor dhe farmaceutik, si dhe mbi 13,000 inspektime sanitare. Angazhimi i inspektorëve të rinj dhe përforcimi i kapaciteteve të inspektoratit ka kontribuar në forcimin e menaxhimit të inspektimeve dhe zbatimin e standardeve shëndetësore. Përfundimisht, është vënë theksi në planifikimin dhe menaxhimin financiar të sektorit, duke respektuar parimet e legjislacionit për menaxhimin e financave publike dhe duke siguruar që aktivitetet janë realizuar në përputhje me ndarjen buxhetore dhe nevojat e sektorit shëndetësor.

## II. Analiza e realizimit të planit të integritetit

Plani i integritetit ka paraparë pesë (5) fusha të përgjithshme të rrezikut dhe tre (3) fusha specifike të rrezikut të përcaktuara si në vijim:

### Fushat e përgjithshme të rrezikut:

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Planifikimi dhe menaxhimi financiar;
- Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
- Komunikimi dhe informimi;
- Ruajtja dhe siguria e të dhënave;

### Fushat e specifike të rrezikut:

- Prokurimi publik dhe menaxhimi i projekteve/kontratave;
- Furnizimi me barna;
- Inspektimet.

Në bazë të këtyre fushave të rrezikshmërisë, janë përcaktuar tridhjetetë (38) përshkrime të rrezikut, derisa për zvogëlimin apo eliminimin e rreziqeve janë paraparë gjashtëdhjetë (60) masa.

Krejt ky proces është paraparë të përcillet në fazë të caktuara nga Koordinatori përgjegjës i emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm. Në kuadër të këtij obligimi është përgatitur edhe ky raport, ku janë bërë hapa të duhur në drejtim të zvogëlimit të rreziqeve respektivisht është rritur dukshëm transparencë në të gjitha këto fusha, përkatësisht masa të përcaktuara në Planin e integritetit institucional të MSh.

Monitorimi i zbatimit të masave të propozuar është realizuar duke kërkuar raport të zbatimit të tyre nga vetë përgjegjësit e masës, apo edhe duke u mbështetur në raporte të tjera të punës siç është ai i zbatimit të Programit të legjisacionit dhe të Programit Kombëtar për Zhvillim.

Nga gjithsej 60 masat e propozuara për zbatim, Ministria e Shëndetësisë ka arritur të realizojë plotësisht 47 masa (78.33%), duke pasur një angazhim të lartë dhe progres të qëndrueshëm në implementimin e strategjive dhe aktivitetave të planifikuara. Këto masa kanë përfshirë zhvillimin e aktivitetave të ndryshme dhe realizimin e projekteve kyçe që kontribuojnë në përmirësimin e sektorëve të shëndetësisë dhe administratës publike.

Një numër i caktuar masash, 9 masa (15%), janë realizuar pjesërisht. Kjo do të thotë se Ministria ka bërë hapa të rëndësishëm, por disa aspekte të implementimit ende kërkojnë kohë për t'u realizuar plotësisht. Këto masa janë ende në proces implementimi dhe, për shkak të disa faktorëve, nuk kanë arritur përfundimin e plotë.

Përkundrazi, 4 masa (6.67%) janë ende të parealizuara, që nënkupton se ka aktivitete dhe projekte që nuk janë realizuar ende, për arsyet e ndryshme në masën më të madhe si shkak mungesës së burimeve apo pengesave të tjera që kanë ndikuar në implementimin e tyre.

### III. Realizimi i aktiviteteve

Aktivitete kryesore në kuadër Planit të integritetit kanë qenë ato të prokurimit publik dhe menaxhimi i projekteve/kontratave, furnizimi me barna, transparenca, respektimi i meritokracisë, zhvillimi i moduleve përkatëse për raportim dhe siguri në të dhëna, si dhe inspektimet.

#### 1. Fusha e rrezikut: Drejtimi dhe menaxhimi

##### Përshkrimi i rrezikut

Në këtë fushë rreziku, janë identifikuar disa faktorë që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e sektorit të shëndetësisë, siç janë mos hartimi i legjisacionit të nevojshëm, mos miratimi i politikave përkatëse dhe mungesa e standardeve për shërbimet shëndetësore, të cilat mund të krijojnë konfuzion dhe të dëmtojnë cilësinë e shërbimeve për qytetarët.

##### Masat e propozuara

Për të adresuar këto sfida, janë propozuar disa masa, si prioritizimi i ligjit bazik në shëndetësi, shfrytëzimi i drafteve të viteve të kaluara për përmirësimin e legjisacionit dhe përdorimi i memories institucionale për të siguruar vazhdimësi dhe zhvillim të qëndrueshëm të politikave. Po ashtu, është propozuar hartimi i Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë për 2030 dhe hartimi i planeve strategjike për sektorin e shëndetësisë bazuar në këtë strategji, si dhe monitorimi i procesit të hartimit të dokumenteve strategjike dhe zbatimi i planit për ndryshimin e UA për hartimin e UPK.

##### Aktivitetet e realizuara

Për të zbatuar masat e propozuara, janë ndërmarrë disa aktivitete të rëndësishme. Projektligji për Shëndetësi është aktualisht në fazën e shqyrtimit të komenteve nga konsultimet publike, ndërsa të gjithë draftet e kaluara janë shqyrtuar dhe konsultuar. Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2025-2030 është miratuar nga Qeveria më 13 nëntor 2024, dhe janë hartuar edhe plane strategjike për sektorin. 46 dokumente strategjike janë nën monitorim dhe janë emëruar grupet punuese për hartimin e 42 udhëzimeve administrative dhe 1 politike. Po ashtu, është duke u zbatuarr UA Nr. 06/2023 për UPK. Këto hapa mbështesin zhvillimin dhe përmirësimin e sektorit të shëndetësisë.

##### Indikatorët kyç të performancës

- Projektligji për shëndetësi është aktualisht në fazën e shqyrtimit të komenteve nga konsultimet publike.
- Të gjithë draftet e viteve të kaluara janë shqyrtuar dhe konsultuar.
- Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2025-2030 është miratuar nga Qeveria më 13 nëntor 2024.
- Krahas SSSh-së, janë hartuar edhe plane strategjike të sektorit të shëndetësisë.
- 46 dokumente strategjike janë aktualisht nën monitorim.
- Sipas planit vjetor të KKUPK të miratuar nga ministri për vitin 2024, janë emëruar grupet punuese për hartimin e 42 UK dhe 1 PK.
- Ua Nr.06/2023 për UPK është gjithashtu në proces implementimi.

## 2. Fusha e rrezikut: Planifikimi dhe menaxhimi finansiar

### Përshkrimi i rrezikut

Rreziku në këtë fushë përfshin disa aspekte kritike të administratës financiare, duke përfshirë moszbatimin e projekteve kapitale, moszbatimin e planit të prokurimit dhe planifikimin e pasaktë të buxhetit. Këto mund të çojnë në vonesa të realizimit të aktiviteteve, mbivendosje të burimeve, si dhe shpenzime të paefektshme.

### Masat e propozuara

Për të zvogëluar rreziqet e mësipërme, janë propozuar disa masa si hartimi i detajuar i Planifikimit Final të Prokurimit, duke specifikuar kërkesat teknike dhe kriteret e kualifikimit, si dhe parashikimin e çmimeve të duhura për tenderim. Monitorimi i zbatimit të planit të prokurimit, përcjellja mujore e pagesave të kapitaleve dhe raportimi i ekzekutimit të penalltive janë gjithashtu masa të rëndësishme. Po ashtu, është parashikuar një planifikim më i detajuar i buxhetit, duke përfshirë barazimin ditor të shpenzimeve dhe njoftimin menjëherë të mbikëqyrësve në rast të mos barazimit.

### Aktivitetet e realizuara

Për të zbatuar masat e propozuara, janë ndërmarrë disa aktivitete konkrete. PFP është përgatitur në platformën e-prokurimit, duke u bazuar në rregullat dhe afatet ligjore. U kushtua vëmendje specifikimit të artikujve, çmimeve dhe afateve për tenderim, sipas Rregullores nr. 001/2022. Raportimi mbi realizimin e planit të prokurimit është bërë në kohë, duke informuar zyrtarët për progresin dhe procedurat. Po ashtu, janë hartuar urdhërblerje dhe njoftuar operatorët për furnizimin dhe menaxhimin e kontratave, ndërprerë kontrata për vonesa dhe mos furnizim, duke konfiskuar garancionet përkatëse. Këto aktivitete janë realizuar në përputhje me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike.

### Indikatorët kyç të performancës

- Është bërë përgatitja e PFP në platformën e-prokurimi.
- Janë hartuar kërkesat me specifikimin e duhur teknik, kriteret e kualifikimit dhe parashikimi i duhur i çmimeve.
- Është monitoruar zbatimi i planit të prokurimit.
- Janë bashkëpunuar me Njësitë Kërkuese dhe ekspertët e USAID-KMI për hartimin e kërkesave tenderuese dhe korrigimin e specifikave diskriminuese.
- Janë punuar urdhërblerjet dhe janë njoftuar operatorët ekonomikë me urdhër blerje dhe kërkesa për furnizim.
- Janë menaxhuar kontratat dhe palët e involvuara në implementimin e kontratave.
- Janë proceduar penaltitë për vonesë nga operatorët ekonomikë.
- Janë ndërprerë disa kontrata për mos furnizim nga operatorët ekonomikë dhe janë proceduar për konfiskim të garacioneve të ekzekutimit.
- Janë realizuar pagesat sipas rregullave financiare në fuqi.
- Janë raportuar dhe bashkëpunuar mbi realizimin e planit të prokurimit, duke informuar zyrtarët autorizues (mbajtësit e buxhetit) rreth aktiviteteve të planifikuara dhe progresit të tyre.

### 3. Fusha e rrezikut: Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve

#### Përshkrimi i rrezikut

Në kuadër të fushës së rrezikut “Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve”, janë identifikuar disa rreziqe kryesore, përfshirë ndikimin politik në rekrutimin e stafit, mos njohjen e rregullave dhe praktikave në fushat kryesore të mbrojtjes së integritetit, mos deklarimin e konfliktit të interesit, dhe vonesat në hartimin e rregulloreve të brendshme për sistematizimin e vendeve të punës. Këto janë trajtuar me disa masa konkrete për të përmirësuar situatën.

#### Masat e propozuara

Për të reduktuar rrezikun dhe përmirësuar performancën, janë propozuar disa masa kyçë: implementimi i parimit të meritës për zhvillimin e stafit përmes trajnimeve të specializuara dhe fushatave vetëdijësuese, hartimi i një politike të qartë për deklarimin e konfliktit të interesit për të siguruar transparencë, dhe procedimi i rregullores së brendshme për të forcuar një kornizë të qartë dhe të qëndrueshme pune.

#### Aktivitetet e realizuara

Aktivitetet e realizuara përfshijnë organizimin e trajnimeve sipas planit të trajnimeve dhe kërkesave të tjera, si dhe përmbushjen e kërkesave për zbatimin e parimeve të legjislacionit për rekrutimin dhe trajtimin e stafit. Po ashtu, është caktuar Zyrtari përgjegjës për regjistrimin e rasteve të paraqitura në përputhje me kërkesat. Rregullorja e brendshme është aprovuar, ndërsa është kryer ristrukturimi i nevojshëm dhe janë nxjerrë aktet e emërimit për të gjithë zyrtarët..

#### Indikatorë kyç të performancës

- Zbatimi i parimeve të meritës në rekrutimin e stafit.
- 100% e trajnimeve të organizuara sipas planit të trajnimit.
- Miratimi dhe implementimi i PSO për deklarimin e konfliktit të interesit.
- Caktimi i zyrtarit përgjegjës për regjistrimin e rasteve të paraqitura.
- Pjesëmarrija e stafeve në aktivitete përritjen e vetëdijes mbi etikën dhe integritetin.
- Rregullorja e brendshme është aprovuar.

### 4. Fusha e rrezikut: Komunikimi dhe informimi

#### Përshkrimi i rrezikut

Në kuadër të kësaj fushe rreziku, janë identifikuar disa sfida kryesore që ndikojnë në efektivitetin e komunikimit dhe transparencës brenda ministrisë. Këto përfshijnë mungesën e një plani të qartë komunikimi, mungesën e një PSO përritjen e përgjegjësisë dhe transparencës përmes komunikimit të brendshëm, si dhe mungesën e monitorimit dhe vlerësimit të komunikimit të brendshëm. Gjithashtu, një tjetër rrezik i identifikuar ka qenë mos publikimi i rezultateve të zbatimit të masave të integritetit.

### Masat e propozuara

Për të adresuar sfidat në fushën e komunikimit dhe transparencës brenda ministrisë, janë propozuar disa masa, duke përfshirë hartimin e një plani të komunikimit për të siguruar një rrjedhë efikase dhe të koordinuar të informacionit. Po ashtu, është propozuar hartimi i një Procedurë Standarde Operative (PSO) për ngritjen e përgjegjësisë dhe transparencës përmes komunikimit brenda ministrisë. Zhvillimi i një vlerësimi të rregullt për komunikimin e brendshëm duke u siguruar që informacioni të shpërndahet dhe të kuptohet siç duhet nga të gjithë punonjësit si dhe publikimi i raportit për zbatimin e planit të integritetit me qëllim të transparencës dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara.

### Aktivitetet e realizuara

Për realizimin e këtyre masave, janë ndërmarrë disa aktivitete konkrete, fillimisht është krijuar grupei punues për hartimin e planit të komunikimit, i cili ka mbajtur takime të rregullta dhe ka përfunduar hartimin e planit, i cili tashmë është miratuar dhe është në fazën e zbatimit. Po ashtu, grupei punues për hartimin e PSO-së për ngritjen e përgjegjësisë dhe transparencës ka finalizuar aktivitetet e tij, duke përfshirë hartimin dhe miratimin e PSO-së, që është gjithashtu në fazën e implementimit. Këto hapa sigurojnë një avancim të rëndësishëm në përmirësimin e komunikimit dhe transparencës brenda ministrisë.

### Indikatorët kyç të performancës:

- 100% e takimeve të grupit punues për hartimin e planit të komunikimit dhe PSO-së janë mbajtur.
- Plani i komunikimit është hartuar dhe miratuar, dhe është aktualisht në proces të zbatimit.
- PSO për ngritjen e përgjegjësisë dhe transparencës është hartuar dhe miratuar, dhe është në proces implementimi.
- Publikimi i raportit për zbatimin e planit të integritetit është i planifikuar dhe do të realizohet si pjesë e transparencës së zbatimit të masave.

## 5. Fusha e rrezikut: Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve

### Përshkrimi i rrezikut

Në këtë fushë rreziku, identifikoohen sfida si mungesa e pasqyrës së saktë të morbiditetit dhe mortalitetit, mos shfrytëzimi i moduleve për burime njerëzore dhe SMSF, dhe mungesa e analizës së rreziqeve për Sistemin e Informimit Shëndetësor (SISh). Këto mangësi ndikonin në menaxhimin e informacionit dhe sigurinë e të dhënave.

### Masat e propozuara

Për të adresuar këto sfida, janë propozuar disa masa për përmirësimin e sigurisë dhe ruajtjes së të dhënave: ngritja e përgjegjësisë për raportimin e të dhënave, popullimi me të dhëna i moduleve ekzistuese, zhvillimi i trajnimeve për shfrytëzimin e moduleve, organizimi i tryezave me IKSHPK dhe institucionale shëndetësore, hartimi dhe zbatimi i planit strategjik për zhvillimin e SISh, zhvillimi i analizës së rreziqeve, dhe përmirësimi i sigurisë kibernetike.

### Aktivitete të realizuara

Aktivitetet për implementimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH) janë në zhvillim dhe udhëhiqen nga Ministria e Shëndetësisë, me një afat implementimi prej 10 vitesh. Popullimi i moduleve ekzistuese dhe zhvillimi i trajnimeve për shfrytëzimin e moduleve janë aktivitete të vazhdueshme për të përmirësuar menaxhimin e burimeve dhe furnizimeve shëndetësore. Po ashtu, janë realizuar takime dhe tryesa për koordinim me IKSHPK dhe institucionet shëndetësore. Plani strategjik për SISH është hartuar dhe miratuar, ndërsa aktivitetet për sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave janë në proces për të siguruar informacionin dhe privatësinë e individëve

### Indikatorët kyç të performancës

- 100% e aktiviteteve të zhvilluara për popullimin e moduleve ekzistuese janë në proces.
- 6 takime të realizuara me njësitë e vaksinimit nga të gjitha komunat.
- Plani strategjik për SISH është hartuar dhe miratuar, dhe është aktualisht në fazën e zbatimit.
- SMSF është funksional në QKMF dhe Institutin e Shëndetit Publik dhe të gjitha vaksinat janë të përfshira në sistem.
- Plani strategjik për zhvillimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor 2024-2030 është hartuar dhe është në fazën e zbatimit.

## 6. Fusha e rrezikut: Prokurimi publik dhe menaxhimi i projekteve/kontratave

### Përshkrimi i rrezikut

Në këtë fushë rreziku, sfidat përfshijnë mos planifikimin e duhur të aktiviteteve, vonesa, mungesë koordinimi, hartimin e pasaktë të kërkesave për tenderim, mos përporthje të çmimeve dhe dëmtim të imazhit të institucionit për shkak të zbatimit të ulët të projekteve kapitale. Rreziqe të tjera janë mos inicimi i aktiviteteve, ndërprerja e kontratave dhe vonesa në vlerësimin e tenderëve, që mund të shkaktojnë humbje mundësish dhe probleme ligjore.

### Masat e propozuara

Për të adresuar këto sfida, është propozuar rishikimi i planifikimit të prokurimit dhe paralajmërimi i inicimit të aktiviteteve për të shmangur vonesat. Kërkesat për tenderim do të hartohen me specifime të sakta dhe çmime të parashikuara për të siguruar tenderë të drejtë dhe transparentë. Aktivitetet përfshijnë edhe zbatimin e udhëzimeve për projekte kapitale, përmirësimin e komunikimit mes njësive dhe trajnimin e menaxherëve dhe zyrtarëve për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e tenderëve.

### Aktivitete të realizuara

Janë realizuar bashkëpunime me ekspertët për të siguruar kërkesa të sakta dhe për të përcaktuar çmimet e tregut. Dokumentet dhe raportet janë publikuar për transparencë. PSO Nr. 05-4366 është në zbatim për inicimin e aktiviteteve të prokurimit, ndërsa sqarimet për komisionet vlerësuese dhe ndihma teknike janë ofruar për të shmangur gabimet. Kontratat që nuk përbushen janë ndërprerë siç kërkon me ligj.

### Indikatorët kyç të performancës

- 100% e aktiviteteve të harmonizimit mes njësive buxhetore për tenderim janë realizuar.

- Zyrtarët autorizues janë njoftuar rreth aktivitetave të planifikuara dhe procedurave të prokurimit.
- 100% e kërkesave tenderuese janë hartuar në bashkëpunim me ekspertët e USAID-KMI për të siguruar korrekëtsi dhe shmangje të specifikave diskriminuese.
- 100% e raporteve dhe dokumenteve të prokurimit janë publikuar në faqen e-prokurimi dhe në uebfaqen e MSH.
- PSO Nr. 05-4366 është hartuar dhe është në proces zbatimi.
- Ndihma teknike dhe profesionale është ofruar për komisionet vlerësuese për të shhangur gabimet në vlerësim.
- Kontratat janë ndërpërre në përputhje me ligjin kur nuk janë përbushur kushtet e tyre.

## 7. Fusha e rrezikut: Furnizimi me barna

### Përshkrimi i rrezikut

Rreziqet në furnizimin me barna përfshijnë mos planifikimin e duhur të aktivitetave nga institucionet shëndetësore, mungesën e barnave, vështirësitë për ofertimin për produktet e listës esenciale dhe jo stabilitetin e tregut farmaceutik. Po ashtu, mos përbushja e detyrimeve ligjore nga operatorët ekonomikë, procedurat e zgjatura ankimore dhe mos ofertimi mund të vonojnë ose ndërpresin furnizimin me barna, duke dëmtuar reputacionin e institucioneve.

### Masat e propozuara

Për të adresuar këto sfida, është propozuar planifikimi i barnave në SMSF dhe i detyrueshëm për produktet esenciale, krijimi i politikave për të rritur interesimin e kompanive farmaceutike dhe lidhja e kontravave kornizë për furnizim afatgjatë. Gjithashtu, lëshimi i referencave negative për operatorët e papërgjegjshëm, zhvillimi i fushatave informuese dhe krijimi i mekanizmave përinjekimive të operatorëve ekonomikë pa marrë parasysh leverdinë ekonomike janë masa për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe konkurrencë të drejtë.

### Aktivitete të realizuara

Aktivitetet përfshijnë planifikimin e barnave dhe produkteve të LBE në përputhje me buxhetin dhe nevojat reale. Lista e Barnave Esenciale është rishikuar dhe janë realizuar kontrata kornizë përfshirë produktet e nevojshme. Aktivitetet vazhdojnë të zhillohen përmirësimin e furnizimit me barna.

### Indikatorët kyç të performancës

- Planifikimi i barnave është realizuar në përputhje me ndarjen buxhetore dhe nevojat reale të KPSh.
- Planifikimi i produkteve të LBE është realizuar me sukses dhe është rishikuar përfshirë produktet e nevojshme.
- Kontratat kornizë janë realizuar aty ku ka qenë e nevojshme, duke siguruar furnizimin e vazhdueshëm me barna.

- Referencat negative për operatorët ekonomikë të papërgjegjshëm janë lëshuar për të siguruar disiplinën dhe transparencën.

## 8. Fusha e rrezikut: Inspektimi

### Përshkrimi i rrezikut

Rreziqet në inspektimin e shërbimeve shëndetësore përfshijnë mungesën e mbikëqyrjes dhe monitorimit të duhur, çka mund të çojë në ofrimin e shërbimeve të pasigurta dhe jo standardizuara. Po ashtu, mungesa e resurseve njerëzore për inspektimet dhe vonesat në ekzekutimin e kundërvajtjeve ndikojnë negativisht në besimin në sistem. Këto sfida krijojnë mundësi për shkelje të ligjit dhe ulje të cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

### Masat e propozuara

Për të përmirësuar inspektimin dhe mbikëqyrjen, propozohet: plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Inspektoratin Shëndetësor, planifikimi i inspektimeve sipas rasteve, rritja e numrit të inspektorëve, angazhimi i zyrtarëve ligjorë të përhershëm, nënshkrimi i memorandumeve për përmbarimin e kundërvajtjeve dhe krijimi i një moduli elektronik për inspektimet.

### Aktivitete të realizuara

Projektligji për Inspektoratin Qendror të Shëndetësisë është miratuar dhe ka krijuar bazën ligjore për përmirësimin e inspektoratit. Reth 2400 inspektime nga inspektorati shëndetësor dhe farmaceutik, dhe mbi 13,000 inspektime sanitare janë realizuar. Inspektorati Shëndetësor ka punësuar 23 inspektorë të rinj dhe Inspektorati Farmaceutik po ashtu ka 23 inspektorë të rinj. Megjithatë, ende ka një zyrtar ligjor të vetëm për të gjitha inspektoratet, çka është një sfidë. Memorandumi për ekzekutimin e gjobave është nënshkruar dhe aktivitetet janë të përfshira në Planin e Punës të Sistemit të Informimit Shëndetësor.

### Indikatorët kyç të performancës

- Projektligji për Inspektoratin Shëndetësor është miratuar dhe është në fazën e zbatimit.
- Afér 2400 inspektimet janë realizuar nga inspektorati shëndetësor dhe farmaceutik, dhe mbi 13,000 inspektimet sanitare janë realizuar, duke siguruar një mbikëqyrje të gjerë.
- Inspektorati Shëndetësor ka punësuar 23 inspektorë të rinj, dhe Inspektorati Farmaceutik ka gjithashtu 23 inspektorë të rinj të punësuar.
- Nënshkrimi i memorandumeve për përmbarimin e lëndëve është realizuar dhe do të mundësojë ekzekutimin e gjobave.
- Një zyrtar ligjor i angazhuar për të gjitha inspektoratet.

## IV. Sfidat

- Për këtë periudhë nuk ka pas vështirësi

## Matrica me të dhënat e Planit të Integritetit

## Raportimi i zbatimit

Nr.	Fusha e Rezikut	Përshtkimi i Rezikut	Masa e propozuar	Njësia/zvrtari përgjegjës	Afat i realizmit	Veprimet e ndërmarrja	Niveli i realizmit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitet	Rekomandimet
1	Drejtimi dhe menaxhimi	Mos hartimi i legjisacionit	Prioritizimi i ligjt bazik;	ZKA	Në vazhdimësi	Projektilgji për shëndetësi është në fazën e shqyrtimit të komenteve nga konsultimet publike.	Pjeserisht e Realizuar	Draft i aktual i projektit gjith	Prioritizim i Ligjit për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor; dhe akieve tjera rrugullativ t sektorit shëndetësor publik	Angazhimi i ekspertëve kombëtar dhe ndërkombëtar të fushës shëndetësore dhe jo vetëm
			Shfrytëzimi i draftave të viteve të kaluara;	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës	9 muaj	Të gjithë draftet e viteve të shkuara janë konsideruar dhe konsultuar	E Realizuar			
			Shfrytëzimi i memories institucionale	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës	3 muaj	Janë shfrytëzuar mundësitë në këtë drejtim	E Realizuar		Largimi i tyre nga institucioni	
		Hartimi SSSh 2030	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës	12 muaj	Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2025-2030 eshtë miratuar nga Qeveria më 13 nëntor 2024	E Realizuar	Gazeta zyrtare		Zbatimi i SSSh	
	Mos miratimi i politikave								Grumbullimi i të dhëna relevante për hartimin e dokumentit	
		Hartimi i planeve strategjike mbi bazën e SSSH 2030	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës	Në vazhdimësi	Krahas SSSh-së janë hartuar edhe plane strategjike të	Pjeserisht e Realizuar	takimet (listat) komunikimi I	Mungesa e ekspertizës së fushave përkatëse	Angazhimi i ekspertëve të fushës	

			sektorit të shëndetësisë	brendshëm, angazhimi I eksperreve	shëndetësore dhe jo vetëm
	Monitorimi i hartimit	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës	Në vazhdimësi	Monitorohen 46 dokumente strategjike	Të raportohet rregullisht sipas kërkesës nga zyrtarët monitorues
	Mungesa e standardeve përofrimin e shërbimeve shëndetësore	Zbatimi i planit për hartimin e UPK	Udhëheqësi i DZhSSh	Në vazhdimësi	Pjeserisht e Realizuar
			Sipas planit vjetor të KKUPK të aprojuar nga ministri përvitin 2024 janë të emëruar grupet punuese për hartimin e 42 UK dhe 1 PK	Listat e pjesëmarrjes dhe matricat e monitorimit	Mos raportimi
		Ndryshimi i UA për hartim të UPK	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës	UA Nr.06/2023 për UPK	E Realizuar
2	Planifikimi dhe menaxhimi financiar	Mos zbatimi i projekteve kapitale	Hartimi i detajuar i Planifikimit Final te Prokurimit	Në vazhdimësi	Është përgatitur PFP ne platformën e-prokurimi, sipas rregullave dhe afateve të parapara ligjore. I është kushtuar vëmendje e theksuar aktiviteteve, specifikimit te artikujve, çmimeve dhe afateve kohore përtenderim.
					Vështrimët e realizimit e plotë të tij
					Rritja e përgjegjishmërisë institucionale

Hartimi i kërkuesave me specifikimin e duhur teknik, kriteret e kualifikimit dhe parashikimi i duhur i çmimeve	Udhëheqësi i Divizionit të prokurimit; Zyrtarët autorizues	Në vazhdimësi	Hartimi i kërkuesave me specifikimin e duhur teknik, kriteret e kualifikimit dhe parashikimi i duhur i çmimeve bëhet sipas Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik	E Realizuar	Rritja e përgjegjishmërisë institucionale
Monitorimi i zbatimit të planit të prokurimit	Udhëheqësi i Divizionit të prokurimit; Zyrtarët autorizues	Në vazhdimësi	Është reportuar dhe bashkëpunuar mbi realizimin e planit të prokurimit, duke i njoftuar zyrtaret autorizues (mbajtësit e buxhetit) rreth aktiviteve te planifikuar, progresin e tyre dhe nevojën për iniciimin e aktiviteteve.	E Realizuar	Vështirësi të natyrave të ndryshme
Mos zbatimi i planit të prokurimit	Hartimi i detajuar i Planifikimit Final te Prokurimit	Udhëheqësi i Divizionit të prokurimit	Është kushtuar vëmendje dhe bashkëpunim me Njësitet Kërkuese dhe ne konsultim te vazhdueshëm me eksperterë	E Realizuar	Rritja e përgjegjishmërisë institucionale


	Percjellja muiore e pagesave ne kapitale	Zyrtari përgjegjës (Divizioni i Financave)	Në vazhdimësi	Janë punuar urdhberbljet, janë njoftuar operatorët ekonomik me urdhër blerje dhe kërkesa për furnizim,	E Realizuar	Ne baze te raporteve	Probleme të çeshtive teknike ne sistem	Trajinim për mbajtësit e buxhetit për
Mos planifikimi dhe ekzekutimi adekuat i buxhetit				menaxheret e kontratave dhe palët e involvuarë ne implementimin te kontratave. Janë procedurë pagesat sipas rregullave financiare ne fuqi;				Fërshtaja e kushteve të kontratës
Raportim i Ekzekutimit të penallitive	Udhëheqësi i Divizioni të Prokurimit; Menaxheri i kontratës	Në vazhdimësi	Sipas Raporteve te menaxhereve te kontratave, janë procedurë penaltitë për çdo vonese nga OE. Gjithashu kemi disa raste te ndëriprejtë se kontratave përmos furnizim nga OE dhe kemi procedurë përkonfiskim te garacioneve te etzekutimit	E Realizuar	Në bazzë të raportit të menaxherit të kontratës	Nuk ka		
Planifikimi i Buxhetit rë detaile	Udhëheqësi i Divizioni të Financave	Në vazhdimësi	Sipas Ligjit Mbi Menaxhimin e Financave Publike, duke respektuar kufijt buxhetor të planifikuar nga	E Realizuar	Në bazzë të kufijve të lejuar buxhetor	Mos planifikimi me kohë nga mbajtësit e buxhetit	Mos planifikimi me kohë nga mbajtësit e buxhetit	Trajinim për mbajtësit e buxhetit për planifikim detaj të buxhetit

		mbajtësit e buxhetit				
		Në bazë të raporteve nga Kontabiliteti dhe SIMFK	E Realizuar	Krahasimi me raportin e MFPT	Mos pranimi i lëndëve me kohë lëndëve me kohë	Lëndët e ekzekutuar me përmbarues të përcjellën me kohë në MSH
	Barazimi ditorë i zyrtarit për barazime dhe njoftimi i me rijshtëresh i mbikëqyrësit në MFPT në rast të mos barazimit	Zyrtari përgjegjës i Divizioni të Financave				
3	Ndikimi Politik në rekrutimin e stafit	Zbatimi i parimit të meritës	Në vazhdimësi	Zbatimi i parimeve të legjisacionit për rekrutim	E Realizuar	Procedurat e rekrutimeve
	Politiqa e burimeve njerëzore, sjetja etike dhe profesionale e të punësuarve	Divizioni i personelit				Minimale
	Mos njohja me rrugullat/praktikat në fushat kryesore të mbrojjes së integritetit	Zhvillimi i stafit përmes trajnimeve adekuate, njoftimit zyrtar, publikimit në web faqe dhe fushatave vëtëdijësuese	Në vazhdimësi	Organizimi i trajnimeve sipas planit të trajnimit dhe kërkesave tjera	E Realizuar	Dëshmitë përpjeshmarrje në trajnime
	Mos deklarimi i konfliktit të interesit	Hartimi i PSO për deklarim të konfliktit të interesit	Zyrtari përgjegjës për hartimin e PSO	PSO është hartuar dhe mirattuar. Është caktuar Zyrtari përgjegjës për regjistrimin e rasteve të paraqitura në bazë të kërkesave	E Realizuar	PSO e publikuar
						Njoftimi I satfit për PSO dhe caktimin e zyrrarit përgjegjës

	Vonesat në hartimin e rregullorëve të brendshme përsistematizimin e vendeve të punës	Procedimi për miratim i rregullores së brendshme politikës	Zyrtari përgjegjës për hartimin e politikës	12 muaj	Është aprovar Rregullorja e brendshme, është kryer ristrukturimi dhe janë nxjerrë Akt emërimet përgjithë zyrtaret	E Realizuar	Publikimi në gazeten zyrtare Rregullorja e re, procedura e re strukturimit dhe Akt emërimet	Minimale	Sistemimi i zyrtarëve aktual në pozitat e krijuara dhe rekrutimi i stafit të ri
4	Komunikimi dhe informimi	Mungesa e planit të komunikimit	Hartimi i planit të komunikimit	Divizioni i komunikimit	6 muaj	Wshëtë krijuar grupi punues për hartimin e planit të komunikimit në kuadër të këtij aktiviteti janë mbajtur takime të grupit dhe aktualisht Planështë i hartuar, i miratuar dhe në zbatim e sipër.	E Realizuar	Është i publikuar në fajen zyrtare të Ministritë së Shëndetësisë	Mungesa e resurseve humane
	Mungesa e PSO pëngritjen e përgjegjësisë, transparentës përmes komunikimit brenda ministrisë	Hartimi i PSO pëngritjen e përgjegjësisë, transparentës përmes komunikimit brenda ministrisë	Zyrtari përgjegjës për hartimin e PSO	6 muaj	është krijuar grupi punues për hartimin e PSO kuadër të këtij aktiviteti janë mbajtur takime të grupit dhe aktualisht PSO është e hartuar, e miratuar dhe në zbatim e sipër	E Realizuar	Është i publikuar në fajen zyrtare të Ministritë së Shëndetësisë	Nuk ka pasur ndonjë vështrimi	Planifikimi I koordinuar me përgjegjësit e aktiviteteve me qëllim të arrites së mbulueshmërisë në këtë drejtim



						përgjegjëshmërisë institucionale
Zhvillimi i trajnimeve për shfrytëzimin e modulit për burime njerëzore	DSISh	Në vazhdimësi	Zhvillimi i trajnimeve për shfrytëzimin e modulit për burime njerëzore është proces i vazhdueshëm.	E Realizuar	Raportet e punës	Mungesa e resurseve humane
Organizmi i tryezave me IKSHPK dhe institacione shëndetësore	DSISh	Në vazhdimësi	Organizmi i tryezave me IKSHPK dhe institacione shëndetësore është aktivitet në proces e sipër	E Realizuar	Raportet e punës	Rritje e vëtdijes së përgjegjëshmërisë institucionale
Zhvillimi i trajnimeve për shfrytëzimin e modulit SMSF	DSISh	Në vazhdimësi	Zhvillimi i trajnimeve për shfrytëzimin e modulit për burime njerëzore është aktivitet i vazhdueshëm	E Realizuar	Punëtori i mbajtura me lista të pjesëmarrjes	Problemet me rjet qeveritar dhe puna e ngadalshme e sistemit
Mos Shfrytëzimi i SMSF	IKSHPK	Në vazhdimësi	6 takime të realizuara me njësitet e vaksinimit nga të gjitha komunitat QKMF (SMSF është funksional në	E Realizuar	Organizimi i trajnimeve & Lista e takimeve	Mungesa e anëtarëve te grupit për shkak te angazhimëve te tyre ne punët e tyre te përfishimë
						Cdo grup pune në tryeza të jep kontributin e tyre që të ketë rezultate konkrete ne zbatimin e

			QKMF dhe IKShPK)				modulit te vaksinimit
Hartimi i Planit strategjik për zhvillimin e SISh	Zyrtari përgjegjës për hartimin e Planit	6 muaj	Plani strategjik për SISh është hartuar dhe miratuar	E Realizuar	Dokumenti I publikuar ne ueb faqe	Dokumenti I publikuar ne ueb faqe	Angazhimi I eksperëtë të lëmisë përkatëse
Popullimi i moduleve ekzistuese me të dhëna	IKShPK	Në vazhdimësi	Sa i përket SMSF në IKShPK të gjitha vaksinat janë të përfshira në sistem si dhe të gjitha daljet e furnizimit bëhen përmes SMSF	E Realizuar	Të gjitha vaksinat e regjistruala dhe furnizimet e OKMF, realizohen përmes SMSF	Mungesa e shtriges së rrejtit qeveritar dhe pajisjeve të nevojshme harduerike në të gjitha njësítë e vaksinimit.	Shtirja e rrejtit ne te gjitha QMF dhe AMF & mirëmbajja e rregullt e SMSF
Zbatimi i planit të strategjik të SISh sipas rekomandimeve të SF	DSISh	Në vazhdimësi	Plani strategjik është i hartuar dhe është në fazën e zbatimit	E Realizuar	Ndërlidhja e aktiviteteve sipas strategjisë	Aritja e afatëve kohore të caktuara sipas planit te veprimit në strategji	Prioritizim I proceseve
Mungesa e analizës së Rieziqeve për SISh	DSISh	3 muaj	Aktivitet i paraparë në Plani Strategjik për zhvillimin e Sistemit të Informimit Shendetësor 2024-2030.	E Parealizuar	Mungesa e resurseve humane, në realizimin e aktiviteteve të parapara	Mungesa e resurseve humane, në realizimin e aktiviteteve të parapara	Angazhimi I eksperëtë të lëmisë përkatëse
Pëmirestim i sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të tij	DSISh	6 muaj	Aktivitet i paraparë në Plani Strategjik për zhvillimin e Sistemit të Informimit	E Parealizuar	Mungesa e resurseve humane, në realizimin e aktiviteteve të parapara		

Angazhimi i ekspertere të lëmisi përkatëse						
			Shëndetësor 2024-2030.			
<b>6</b>	Prokurimi publik dhe menaxhimi i projekteve/kont ratave	Mos planifikimi i duhur	Rishikimi i Planifikimit të Prokurimit	Udhëheqësi i Divizionit të prokurimit	I është kushtuar vëmendje e theksuar harmonizimit të aktiviteteve ne mes njësive buxhetore, specifikimit te artikujve dhe afateve kohore përtenderim;	E Realizuar
		Neglizhenca përinicimin te aktiviteteve	Paralajmërimi përinicimin e aktiviteteve ne përputhje me planin e prokurimit	Udhëheqësi i Divizionit të prokurimit	Në vazhdimësi	E Realizuar
		Hartimi jo i duhur i kërkësave përtenderim	Hartimi i kërkësave përtenderim me specifikimin e duhur teknik, kriteret e kualifikimit dhe parashikim të duhur të çmimeve.	Në vazhdimësi Njësia Kërkuese	I është kushtuar vëmendje dhe bashkëpunim me Njësiet Kërkuese dhe ne konsultim te vazhdueshëm me eksperjet e USAID-KMI përhartimin e duhur te kërkësave tenderuese, korrigojmin e	E Realizuar
		Mos përputhje me çmimet e parashikuara dhe tregut				Raportet e punës
						Raportet e punës

Dëmtimi i imazhit te institucionit për nivelin e ultë të zbatimit të projekteve kapitale	Publikimi i raporteve dokumenteve dhe kontratave të prokurimit	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit	Në vazhdimësi	Të publikuara në faqen e-prokurimi edhe ne ueb faqen e MSH-se.	E Realizuar	Ueb faqe OShP - MSh
Insistimi i iniciimit të aktiviteteve kapitale në përputhje me UA 04/2009 dhe UA 06/2009 (Definimi i projekteve kapitale) dhe UA 06/2009 (Kriteret e përzgjedhjes dhe prioritizimi i projekteve kapitale)	Zbatimi i udhëzimeve UA 04/2009 dhe UA 06/2009 (Definimi i projekteve kapitale) dhe UA 06/2009 (Kriteret e përzgjedhjes dhe prioritizimi i projekteve kapitale)	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit	Në vazhdimësi	Është punuar dhe është ne zbatim PSO (Procedura Standarde Operative) Nr. 05-4366 për Inicimin e aktiviteteve te prokurimit për kontratat për punë ndërtimore	E Realizuar	Raportet e punës
Mos kontraktimi	Përmiresimi i komunikimit	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit	Në vazhdimësi	Janë dhënë sqarime te kërkua për komisionet vlerësuese, janë dhëne ndihmese teknike dhe profesionale me qellim qe te eviohen gabimet ne vlerësimi.	E Realizuar	Raportet e punës
Ndërprija e kontratës	Trajimi i menaxherëve të kontratave	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit	Në vazhdimësi	Ndërprija e kontratave bëhet atëherë kur nuk	E Realizuar	Raportet e punës

		përbushjen kontratat e punës				
		Në vazhdimësi	Aktiviteti nuk është realizuar	E Parealizuar	Aktiviteti nuk është realizuar për shkak të angazhimeve USAID/RMI dhe ndryshimit të rrugolores	Aktiviteti do të zhvillohet në gjashëmujorin e parë të vitit 2025
	Mos vlerësimi i tenderëve në kohë në përputhje me dispozitat e LPP-së	Trajinimi zyrtarëve për vlerësimin e tenderëve	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit			
7	Furnizimi me barna	Mos planifikimi i mirëfilltë nga institucionet shëndetësore të KPSH	Planifikimi i barnave në SMSF	Udhëheqësi i Divizionit të Farmacisë	12 muaj	Planifikimi është bërë në përputhje me ndarjen buxhetore dhe nevojat reale për KPSH
	Mungesa e barnave në institucione shëndetësore	Mungesa e barnave në institucione shëndetësore	Planifikimi obligator i të gjitha produkteve në listën esenciale	Udhëheqësi i Divizionit të Farmacisë	Në vazhdimësi	Planifikimi I produkteve të LBE
	Sasi të vogla të planifikim nga institucionet shëndetësore të KPSH për disa produkte të listës esenciale që konsiderohen jo të favorshme nga operatorë ekonomik	Krijimi i politikave favorizues përriti të interesimit të kompanive farmaceutike për regjistrim të barnave	ZKA	12 muaj	Është revideuar LBE	E publikuar ne ueb faqe
						Vështrimi në tritjen e interesimit të OE
						Rritja e përjetësisë humane të OE

	për oferta dhe kontraktim	Lidhja e kontratave kornizë	Udhëheqësi i Divizionit të Farmacisë	Në vazhdimësi	Janë realizuar kontratat kornizë, aty ku ka qenë e nevojshme	E Realizuar	E-prokurim dhe SMSF	Lidhja e kontratave me kohë	Gjetja e rrugëve alternative brenda kornizave ligjore për produktet me sasi te vogla ne planifikim dhe çmimet e ulta te tyre
Jo stabiliteti i tregut për produkte farmaceutik të listës esenciale	Mos përbmbushja e detyrimeve ligjore nga ana e operatorëve ekonomik	Lëshimi i referencave negative për operatorët ekonomik të papërgjegjishnëm	Udhëheqësi i Divizionit të Farmacisë	Në vazhdimësi	Janë lëshuar referenca negative	E Realizuar	e-prokurimi	Pasojë kryesore janë në mungesën ne furnizim me barna. Papërgjegjshmëria e operatorëve	Të shteren të gjitha mundësitetë deri në shkëputje kontrata
Zhvillimi i fushatave informuese për publikun përrëndësing e furnizimit me barna në trethanat e Kosovës	Divizioni i Komunikimit me Publikun	Në vazhdimësi	Aktivitetë të cilat realizohen në vazhdimësi	E Realizuar	Raportet dhe aktivitetet e publikara	Pasojë kryesore janë në mungesën ne furnizim me barna	Rritja e përgjegjshmërisë institucionale		
Procedurat ankimore të tej zgjatura në OShP	Komunikimi i regulit me OShP në lidhje me rëndësinë e furnizimit me barna	Udhëheqësi i Divizionit të Farmacisë	Në vazhdimësi	Aktivitetë të cilat realizohen në vazhdimësi	E Realizuar	Raportet e punës	Vështirësi në mirëkuptimin dhe përgjegjshmërinë OE	Rritja e përgjegjshmërisë institucionale dhe OE	

Mos ofertimi i operatorëve ekonomik në proces të tenderimit	Krijimi i mekanizmit për inkurajimin e apikimit të operatorëve ekonomik pa marrë parasysh leverdinë ekonomike	Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit	9 muaj	Aktivitet i cili realizohet në vazhdimësi	E Realizuar	Vështrimi në mirekuptimin dhe përgjegjshmërinë nga OE
Humbje reputacionitit	Komunikimi i rregullt me publikum në rast se tenderët përfundojnë barna përfundojnë në procedura të ankesave	Divizioni i Komunikimit me Publikun	Në vazhdimësi	Aktivitet i cili realizohet në vazhdimësi	E Realizuar	Vështrimi në mirekuptimin dhe përgjegjshmërinë nga OE
8	Inspektimi	Mungesa e duhur e mbikëqyrjes dhe monitorimi i subjekteve/institucioneve dhe profesionistëve shëndetësor që ofrojnë shërbime shëndetësore, shërbimeve farmaceutike dhe sanitare	Plotësim Ndryshimi i Ligjt për Inspektoratin shëndetësor	12 muaj	Projektligj për Inspektoratin qendror të shëndetësisë është aprovuar në Qeveri me vendimin nr.03/238, datë 18/12/2024	Pjesërisht e Realizuar
		Inspektimi mië të planifikuar dhe sipas rasteve të paraqitura	Inspektorati Shëndetësor / Inspektorati Farmaceutik/ Inspektorët Sanitar	Në vazhdimësi	Aftë 2400 inspektime nga inspektorati shëndetësor dhe farmaceutik dhe Mbi 13000 inspektime sanitare	Vështrimi të ndryshme teknike, hapësirat e nevojishme dhe aspektet të tjera logistike
						Përmirësimi I kushteve logistike dhe ritja e sigurisë për personelin

Mungesa e resurseve njerëzore për inspektime	Rritja e numrit të inspektoreve shëndetësor dhe sanitari	Inspektorati Shëndetësor / Inspektorati farmaceutik/ Inspektorët Sanitar	Në vazhdimësi	Inspektorati Shëndetësor ka punësuar 23 Inspektor të rinjë; Inspektorati Farmaceutik tanë përbëhet nga 23 Inspektor	E Realizuar	Staff I rekrutar
	Angazhimi i zyrtarëve ligjor të përhershëm në inspektorat	Inspektorati Shëndetësor / Inspektorati farmaceutik/ Inspektorët Sanitar	9 muaj	Lidhur me angazhimin e stafit ligjor të përhershëm është vetëm një zyrtar ligjor për të gjitha Inspektoratet	Pjesërisht e Realizuar	Zyrtari I angazhuar
	Nënshkrimi i memorandumit përmbarimin e kundërvajjeve inspekuese	Inspektorati Shëndetësor / Inspektorati farmaceutik/ Inspektorët Sanitar	6 muaj	Memorandumi përmbarimin e lëndëve (ekzekutimin e gjobave) është nënshkruar nga MSh	E Realizuar	Memorandumi i nënshkruar
	Vonesat në ekzekutim të kundërvajjeve inspekuese	Krijimi i modulit elektronik për inspektime	SISh	9 muaj	aktiviteti është i paraparë në Planin e punës të SISh	pjesërisht e Realizuar
					mungesa e resurseve humane	angazhimi I staffit të nevojshëm profesional